



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 2333/prot.

Tiranë, më 18.08.2025

VENDIM
Nr. 34, datë 18.08.2025

PËR

**PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E MJETEVE TË PËRPUTHSHMËRISË (AMC),
MATERIALET UDHËZUESE (GM) DHE SPECIFIKIMET E CERTIFIKIMIT (CS)
TË EASA, PËR PËRDORIM PËR ZBATIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT TË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NR. 178, DATË 20.12.2023, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të Nenit 14, pika (ë), të Ligjit Nr. 53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, për zbatimin e pjesës ARA.GEN.120 dhe ORA.GEN.120 “Mjetet e përputhshmërisë” të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 178, datë 20.12.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, e ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.111, datë 31.07.2025,

V E N D O S A:

1. Pranimin e mjeteve të pranueshme të përputhshmërisë (AMC), materialet udhëzuese (GM) dhe specifikimet e certifikimit (CS) të EASA, për zbatimin e Rregullores (BE) 1178/2011 “Për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin në aviacionin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:
 - a) *AMC & GM to Commission Regulation (EU) No 1178/2011 — Issue 1, Amendment 1 dhe 2;*
 - b) *AMC & GM to Part-ARA — Issue 1 dhe Amendment 1 deri në 13;*
 - c) *AMC & GM to Part-CC — Amendment 1;*
 - d) *AMC & GM to Part-FCL — Issue 1 dhe Amendment 1 deri në 13;*
 - e) *AMC & GM to Part-MED — Issue 2 dhe Amendment 1;*
 - f) *AMC & GM to Part-ORA — Issue 1 dhe Amendment 1 deri në 8;*
 - g) *AMC & GM to Part-DTO — Issue 1 dhe Amendment 1 dhe 2;*
 - h) *CS-FSTD(A) Issue 2;*
 - i) *CS-FSTD(H) Initial issue.*

2. Për të siguruar përputhshmërinë me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 178, datë 20.12.2023 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, e ndryshuar me Urdhrin e Ministrit Nr.111, datë 31.7.2025, do të përdoren AMC, GM dhe CS të EASA në gjuhën angleze, të pranuar me këtë vendim dhe të publikuara nga EASA në adresën e internetit:

Aircrew | EASA <https://www.easa.europa.eu/en/regulations/aircrew#amc--gm-to-regulation-eu-no-1178-2011>

3. Ngarkohet Drejtoria e Trajnimit dhe Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Trajnimit dhe Licencimit të marrë masa për njoftimin e Organizatave të Trajnimit dhe publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

